



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 53, datë 27.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“6 BANESA INDIVIDUALE 1 DHE 2 KATE”, ME VENDNDODHJE NË DHËRMI,  
BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Z. Xhorxhi Aleks, Znj. Ledia Aleks, Z. Maksim Marku, Z. Romeo Sherko, Z. Bergin Gjonaj dhe Z. Etrit Puka, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “6 banesa individuale 1 dhe 2 kate”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues Z. Xhorxhi Aleks, Znj. Ledia Aleks, Z. Maksim Marku, Z. Romeo Sherko, Z. Bergin Gjonaj dhe Z. Etrit Puka.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU 4.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 31/12/2024